

Shefi i UNMIK-ut dhe komandanti i KFOR-it në Prizren

# Ryker e Kater thonë se në Kosovë po ndërtohet shoqëri demokratike

Shefi i UNMIK-ut, Joakim Ryker tha se veprat si "Loyola", në të cilën janë të ftuar personalitete të të gjitha besimeve, tregon se Kosova është një shoqëri demokratike dhe është në rrugë të mirë drejt ardhmërisë së saj, duke shtuar se "kjo është kohë vendimtare për Kosovën"

## Refki Reshitaj

Dy vjet pas vënies së gurthemelit për ndërtimin e gjimnazit të parë privat në Kosovë, në ambientet e tij në Prizren, që është i pari i këtij lloji në Kosovë, është mbajtur të hënën ceremonia e përfundimit të këtij projekti, ku tash mësimet po i ndjekin shumë nxënës të këtij rajoni. Në këtë ceremoni, pos përfaqësuesve të pushtetit lokal dhe atyre qendror, ishin të pranishëm edhe zyrtarë nga Vatikani si dhe shefi i UNMIK-ut, Joakim Ryker dhe komandanti i KFOR-it, gjenerali Roland Kater.

Me rastin e përfundimit të këtij projekti për gjimnazin e parë privat "Loyola" në Prizren, ata kanë vlerësuar se në Kosovë po ndërtohet një shoqëri demokratike, që është parakushti themelor i të ardhmes së mirë për të gjithë ata që jetojnë këtu. Veprat si gjimnazi "Loyola", në të cilën janë të ftuar personalitet të të gjitha besimeve, tregon se Kosova është një shoqëri demokratike dhe është në rrugë të mirë drejt ardhmërisë së saj, ka thënë shefi i UNMIK-ut Ryker, i cili duke folur për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova, ka thënë se "kjo është një kohë vendimtare për Kosovën", ndërkaq që ka shtuar se në Kosovë po ndërtohet shoqëri demokratike, që është parakushti themelor i të ardhmes së mirë për të gjithë ata që jetojnë në këtë vend.

Komandanti i KFOR-it në Kosovë, gjenerali gjerman, Roland Kater, ka përgëzuar punën e mirë që po bëhet në këtë shkollë, duke e vlerësuar popullatën e Kosovës si ndër më të renë në Europë dhe kjo, siç tha ai, përbën



optimizëm të madh për të ardhmen e saj.

"Dëshiroj që nga ky gjimnaz të dalë një sinjal i përbashkët për të gjithë, pa dallim etnie apo gjinie, pasi kultura dhe arsimit janë kryesoret për një shoqëri", ka thënë gjenerali Kater, dhe ka shtuar se trupat paqeruajtëse të KFOR-it do t'i ndihmojnë të gjitha shkollat që të ecin përpara. Për rezultatet e mirë të arritura në këtë shkollë, e cila është vendosur në një kompleks të tërë në hyrje të qytetit të Prizrenit, ku pos lokaleve mësimore janë edhe shumë objekte të tjera përcjellëse, foli drejtuesi i kësaj shkolle, Walter Happel. Ai tha se ky institucion arsimor është ndërtuar dhe funksionon si dhuratë për familjet e këtushme dhe se këtu fëmijët e tyre shkollohen sipas standardeve evropiane, ka

thënë Happel, i cili ka vlerësuar lart punën e deritashme që është bërë në gjimnazin "Loyola". Ai ka shtuar se duam të bëjmë diç për fëmijët e Kosovës, në mënyrë që t'i përmirësojmë shanset e tyre për integrim në një Europë, e cila çdo ditë e më tepër po bashkohet. Andaj, ne mendojmë se për këtë, shkollimin nuk duhet kuptuar vetëm si dhënie të mësimit, por edhe si parakusht të rëndësishëm për përfshirjen e tyre në rrjedhat bashkëkohore, ka thënë Walter Happel. Në këtë ceremoni rasti ka folur edhe Ergjan Shpat, nënkryetar i komunës së Prizrenit, i cili pasi ka përkujtuar mbështetjen që ky gjimnaz në Prizren e kishte edhe nga pushteti lokal, ka përshëndetur rezultatet e arritura këtu dhe atë për një kohë jo edhe aq të gjatë të funksionimit. ■